

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7068  
E martë, 12 dhjetor 2023  
Çmimi 0.50 €

Kurti në Kongresin e SPD-së në Gjermani: Kosova, shtet i së drejtës dhe barazisë për të gjithë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

MBAHET KONFERENCA "NGA TRANSPARENCA TE BESIMI: ZGJIDHJET PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR NË NIVEL INSTITUCIONAL" | FAQE 4-5

## HAXHIU THOTË SE PO KA MUNGESË TË VEPRIMEVE NGA ANA E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË PËR T'I TRAJTUAR LËNDËT



Më Ministra e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije të hënën se po vërehet mungesë e veprimeve nga ana e institucioneve të drejtësisë për t'i trajtuar lëndët, për të cilat thotë se e gjithë qeveria ia dorëzuar mbi 200 sosh. Në konferencën "Nga

transparenca te besimi: Zgjidhjet për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar në nivel institucional", Haxhiu ka theksuar se ndonëse mbetet ende shumë për të bërë, Kosova tashmë po vlerësohet nga indekse ndërkombëtare në

përpjekjen e saj për t'i luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ndërkaj ambasadori britanik në Prishtinë, Nicholas Abbott, ka thënë se korrupsioni ka ulur besimin e qytetarëve në institucione dhe ka rritur pabarazinë shoqërore

### AKTUALE



BISLIMI: KONTRATA 'ELEKTROSEVER' - KEDS ËSHTË HAP DREJT NORMALIZIMIT TË FURNIZIMIT ME RRYMË NË VERI | F. 5

MASË PARABURGIMI PËR TË DYSHUARIN E KATËRT NË RASTIN E VRASJES SË LIRIDONËS | F. 5

OFICERËT E FSK-së SHKËLQEJNË NË TRAJNIMET NDËRKOMBËTARE NË SHBA | F. 6

### EKONOMI



NGROHTORJA SOLARE, MFPT DHE "TERMOKOS"-I NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE 80 MILIONË EURO | F. 8

HOTI: AMBIENTI PËR BIZNES NË VITIN 2023 ËSHTË PËRKEQËSUAR | F. 8

### KULTURË



HYSENI PËR HERË TË TRETË 'YLLI I JAVËS': 'LEGJENDAVE' U PREMTOJ SHUMË GOLA | F. 10

ZGJEDHET KRYEPROKURORI I PROKURORISË SPECIALE DHE KRYEPROKURORËT E PROKURORIVE THEMELORE NË PRISHTINË DHE GJAKOVË | F. 3



RENOVA PUTZ  
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

PRINCESHA GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

INFINITY Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...



## Navalny dërgohet në një burg të ri, nuk dihet vendndodhja e tij

MOSKË, 11 DHJETOR - Politikani opozitar rus Aleksei Navalny nuk është më në burgun IK-6 Melekhovo, pasi është bartur në një burg tjetër, vendndodhja e të cilit nuk dihet ende, tha të hënën zëdhënësja për medie e kritikut të Kremlinit, Kira Yarmysh. "Ata sapo dolën nga ndërtesa e IK-6 Melekhovo dhe i thanë një avokati se i burgosuri Navalny nuk është më në listën e të burgosurve. Ata nuk pranojnë të thonë nëse ai është transferuar", tha Yarmysh në rrjetin social X.

Më herët gjatë ditës, Yarmysh tha se Navalnyt nuk i ishte lejuar të komunikonte për gati një javë, ndërsa avokatëve të tij nuk i ishte lejuar ta takonin atë në burg. Navalnyt, një prej kritikëve më të zëshëm të presidentit rus Vladimir Putin, në gusht iu rrit dënimi në 19 vjet burgim, pasi u gjet fajtor për krijimin e një organizate ekstremiste dhe u transferua në një burg "me regjim më të ashpër". Dënimi paraprak i ishte shqiptuar më 2021, pasi kishte arritur në Moskë nga

Gjermania, ku ishte trajtuar nga një helmim, për të cilin ai ka fajësuar Kremlinin. Para se të burgosej ai ishte opozitari më i zëshëm që organizoi protesta të mëdha kundër qeverisë ruse. Tre prej avokatëve të Navalnyt - Vadim Kobzev, Igor Sergunin dhe Aleksei Lipster - janë arrestuar në tetor dhe po ndiqen penalisht për pjesëmarrje në një komunitet ekstremist për shkak të lidhjeve të tyre me Navalnyn dhe me fondacionin e tij kundër korrupsionit.



## Australia do ta përgjysmojë numrin e migrantëve që pranon



CANBERRA, 11 DHJETOR - Qeveria australiane ka thënë se do ta përgjysmojë numrin e migrantëve që pranon, teksa tenton ta përmirësojë sistemin "e prishur" të imigrimit. Ky vend mëton të pranojë 250 000 njerëz - shifër në përputhje me nivelet para pandemisë së koronavirusit - deri në qershor të vitit 2025. Rregullat për viza, për studentët ndërkombëtarë, dhe punëtorët e pakualifikuar, do të ashpërsohen,

po ashtu, sipas planit të ri. Migrimi është rritur në nivele rekorde në Australi, duke e shtuar presionin në fushën e strehimit dhe infrastrukturës. Në anën tjetër, Australia ka nevojë për punëtorë të kualifikuar dhe tenton të tërheqë sa më shumë të tillë. Duke e paraqitur një strategji 10-vjeçare për migrimin, ministrja e Brendshme australiane, Clare O'Neil, ka thënë se sistemi i

migrimit është "rënuar" prej qeverisjeve paraprake. Një rishikim paraprak këtë vit ka gjetur se sistemi është "tërësisht i prishur", shumë kompleks dhe në nevojë për "reformë të madhe". Një rekord prej 510 000 njerëzve kanë shkuar në Australi këtë vit, mirëpo ministrja është zotuar për ta kthyer situatën nën kontroll. Në mesin e kërkesave të reja për migrantët do të jetë një nivel i gjuhës angleze.

## Disa shtete arabe hyjnë në grevë në solidaritet me Gazën

AMAN, 11 DHJETOR - Punëtorë, biznese dhe institucione janë duke marrë pjesë në një grevë të përgjithshme të hënën, në disa vende arabe, për të shprehur solidaritet me Gazën, dhe duke bërë thirrje për armëpushim të menjëhershëm. Në Jordani shumë rrugë janë parë të thata dhe dyqanet janë mbyllur në kryeqytetin Amman, si dhe disa qytete të tjera të Jordanisë, kanë raportuar mediet lokale atje. Banerët janë vendosur në dyert e dyqaneve të mbyllura, duke treguar për pjesëmarrjen e tyre në grevë. Në Liban janë mbyllur edhe shkollat dhe institucionet

qeveritare. Ministri i Edukimit në Mauritani i ka shtyrë të gjitha mësimet e caktuara për të hënën, "për t'i lejuar studentët që të marrin pjesë në aktivitetet për mbështetje të Gazës". Bizneset, shkollat dhe zyrat qeveritare janë mbyllur nëpër pjesë të Bregut Perëndimor. Në raportimet e medieve është thënë se punëtorë të transportit publik, bankave dhe universiteteve i janë bashkuar grevës. Shumë fraksione palestineze dhe grupe të aktivistëve kanë bërë thirrje për grevë globale të hënën, me kërkesën për armëpushim në Rripin e Gazës.



Izraeli e ka bombarduar të hënën qytetin kryesor në jug të Gazës, Han Junis, pasi grupi palestinez Hamas ka paralajmëruar se asnjëri prej

pengjeve izraelite nuk do të largohet gjallë prej territorit derisa të përbushen kërkesat për lirim të të burgosurve.

Hamasi, grupi radikal që udhëheq Gazën, është shpallur grup terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian. Hamasi e ka nxitur këtë luftë, pasi ka kryer sulmet më vdekjeprurëse ndonjëherë në tokën izraelite, më 7 tetor, duke i vrarë rreth 1 200 njerëz, sipas të dhënave izraelite, dhe duke marrë rreth 240 pengje që i ka dërguar në Gazë. Izraeli është përgjigjur me ofensivë ushtarake, e cila e ka shndërruar një pjesë të mirë të Gazës në gërmadhë, dhe ka vrarë rreth 17 990 njerëz, kryesisht gra dhe fëmijë, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze.

## Serbia dhe Kina nënshkruajnë memorandum për pagesa në juan

BEOGRAD, 11 DHJETOR - Banka qendrore e Serbisë dhe ajo e Kinës nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për krijimin e një marrëveshjeje kliringu dhe përcaktimin e një banke kliringu në Serbi për juanin kinez, njoftoi më 11 dhjetor Banka Kombëtare e Serbisë (NBS). Guvernatorja e NBS-së, Jorgovanka Tabaković dhe guvernatori i Bankës

Kombëtare të Kinës, Pan Gongsheng, nënshkruan një dokument që rregullon bashkëpunimin në lidhje me kryerjen e transaksioneve në juan kinez nga bankat në Serbi. "Ky është një hap tjetër për përmirësimin e bashkëpunimit kinezo-serb në fushën e shërbimeve financiare, me të cilin ne krijojmë kushte për përmirësimin e shlyerjeve dhe promovimin e

transaksioneve në juan kinez", tha Tabaković. Kliringu është një marrëveshje ndërmjet subjekteve bankare mbi bazën e së cilës bëhet pagesa. Ajo thjeshton transaksionet e pagesave ndërmjet individëve dhe personave juridikë. Kliringu rregullohet zyrtarisht nga banka qendrore ose organizata të tjera kompetente ekonomike dhe financiare.





## Haxhi Shala intervistohet nga Gjykata Speciale



PRISHTINË, 11 DHJETOR - Ish-eprori i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Haxhi Shala, është ftuar të hënën për intervistim nga Gjykata Speciale. Lajmin për "Radion Evropa e Lirë" e ka konfirmuar i biri i Shalës, Flakroni. Ai ka thënë se Haxhi Shala është duke u intervistuar në zyrat e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) në Fushë-Kosovë. "E kanë ftuar për intervistim. Deri më tani e kemi vetëm këtë informatë. Nuk i dimë arsyet. Tani ndodhet në zyrat e EULEX-it në Fushë-Kosovë". Zyra e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë nuk ka dashur ta komentojë këtë rast, por ka konfirmuar se janë duke u zhvilluar operacione në Kosovë. "Zyra e Prokurorit të Specializuar

është duke zhvilluar operacione të vazhdueshme në Kosovë dhe nuk ka komente të mëtejme", kanë thënë për Radion Evropa e Lirë (REL) nga kjo zyrë. Ndërsa kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Malishevë, Metush Kryeziu, i ka thënë REL-it se forcat e EULEX-it kanë mbërritur në mëngjes në shtëpinë e Haxhi Shalës në fshatin Banjë të Malishevës. Sipas tij, aty po zhvillohen bastisje. "Në mëngjes kanë ardhur forcat e EULEX-it në pronat e tij, si zakonisht Specialja siç bën, arsyet nuk i dimë. Bastisjet po vazhdojnë në shtëpinë në Banjë të Malishevës. Ai është marrë në pyetje, është dërguar në EULEX në Fushë-Kosovë, për më shumë nuk dimë", ka thënë Kryeziu.

Së fundi Specialja e ka arrestuar edhe ish-kryetarin e Malishevës, Isni Kilaj, nën dyshimin për pengim të drejtësisë. Ndërkaq në muajin tetor janë arrestuar dhe transferuar në objektin e paraburgimit në Hagë edhe Sabit Januzi dhe Ismet Bahtjari, të cilët, sipas Speciales, "akuzohen për frikësim dhe tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përfshirë përmes kërcënimit të rëndë". Gjatë këtij viti Specialja ka kryer bastisje në Kosovë. Pa dhënë shumë detaje, prokuroria në Hagë kishte bërë me dije se operacionet janë zhvilluar në një proces hetimor që përqendrohet në vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

### Rastet e tjera në këtë gjykatë

Gjykata Speciale heton krimet e pretenduara të anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë në periudhën janar 1998 - dhjetor 2000. Gjykata e ka selinë në Hagë të Holandës, por funksionon sipas ligjeve të Kosovës. Aktualisht, në Gjykatën Speciale është duke vazhduar gjyqi i ish-pjesëtarëve të UÇK-së, njëherësh ish-presidentit të Kosovës Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si dhe ish-anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rexhep Selimi, me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të gjithë janë deklaruar të

pafajshëm. Në një proces tjetër gjyqësor po gjykohet ish-pjesëtari i UÇK-së, Pjetër Shala. Ai akuzohet për drejtimin e një burgu të improvizuar, ku supozohet se janë keqtrajtuar disa njerëz dhe njëri prej tyre është vrarë. Vetë Shala ka thënë se akuzat ndaj tij janë të fabrikuara. Në dhjetor të vitit të kaluar Gjykata Speciale e ka shqiptuar dënimin e parë për krime lufte. Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, është dënuar me 26 vjet burgim për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. Më herët nga Dhomat e Specializuara në Hagë janë dënuar Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj për pengim të administrimit të drejtësisë. Gucati është liruar ndërkohë me disa kushte.

## Zgjedhet kryeprokurori i Prokurorisë Speciale dhe kryeprokurorët e prokurorive themelore në Prishtinë dhe Gjakovë

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Jetish Maloku, ka zhvilluar takimin e 238 me radhë dhe, sipas agjendës, me vetëm tri pika të parapara në rendin e ditës. Gjatë këtij takimi janë zgjedhur kryeprokurorët e tri prokurorive të rëndësishme të vendit, me ç'rast fillimisht anëtarët e KPK-së votuan me shumicë votash dhe zgjedhën Blerim Isufaj për një mandat në krye të Prokurorisë Speciale, duke filluar nga 1 janari 2024. Po në të njëjtin takim KPK-ja votoi edhe për zgjedhjen e kandidatit të vetëm për kryeprokuror të

Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Zejnulla Gashi, prokuror i kësaj prokurorie, i cili u zgjodh me një mandat katërvjeçar, duke filluar nga 1 janari 2024. Po në pikën tre të këtij takimi Këshilli votoi edhe për zgjedhjen e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Enis Gashi, prokuror i kësaj prokurorie, i cili do ta udhëheqë këtë prokurori gjatë katër vjetëve të ardhshëm, duke filluar nga 1 janari 2024. Zgjedhjes së kryeprokurorëve u ka paraprirë trajtimi i raportit të Komisionit për Rishqyrtim dhe trajtimi i dy raporteve të paneleve vlerësuese.







MBAHET KONFERENCA “NGA TRANSPARENCA TE BESIMI: ZGJIDHJET PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR NË NIVEL INSTITUCIONAL”

# Haxhiu thotë se po ka mungesë të veprimeve nga ana e institucioneve të drejtësisë për t'i trajtuar lëndët

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije të hënën se po vërehet mungesë e veprimeve nga ana e institucioneve të drejtësisë për t'i trajtuar lëndët, për të cilat thotë se e gjithë qeveria ia dorëzuar mbi 200 sosh. Në konferencën “Nga transparenca te besimi: Zgjidhjet për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar në nivel institucional”, Haxhiu ka theksuar se ndonëse mbetet ende shumë për të bërë, Kosova tashmë po vlerësohet nga indekse ndërkombëtare në përpjekjen e saj për t'i luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ndërkaq ambasadori britanik në Prishtinë, Nicholas Abbott, ka thënë se korrupsioni ka ulur besimin e qytetarëve në institucione dhe ka rritur pabarazinë shoqërore

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 11 DHJETOR** - Iniciativa CorrWatch, e ndërmarrë nga konsorciumi i organizatave i përbërë nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), me mbështetjen e Ambasadës së Britanisë kanë organizuar të hënën konferencën “Nga transparenca te besimi: Zgjidhjet për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar në nivel institucional”.

Drejtoresha e GLSP-së, Arbresha Loxha-Stublla, ka theksuar se ky

projekt ka në qendër monitorimin e rregullt në pesë fusha kryesore. “Proceset e rekrutimit në sektorin publik; praktikat e prokurimit publik dhe menaxhimi i kontratave; shpërndarja e granteve dhe subvencioneve; dhënia e lejeve, licencave dhe tarifave dhe performanca e menaxhimit të ndërmarrjeve publike”, ka thënë Loxha-Stublla. Sipas saj, ky projekt ka për qëllim të ofrojë gjithashtu ekspertizë dhe mbështetje të vazhdueshme për institucionet publike për t'i eliminuar parregullsitë dhe shkeljet ligjore që mund të hasen në mënyrë që të njëjtat të

përmirësohen dhe të vendosen praktika të mira. Madje tha se synohet që përmes praktikave të mira ta parandalojnë korrupsionin dhe ndikimin e krimit të organizuar në institucionet publike. Ambasadori britanik në Prishtinë, Nicholas Abbott, ka thënë se korrupsioni ka ulur besimin e qytetarëve në institucione dhe ka rritur pabarazinë shoqërore. Sipas tij, lufta kundër korrupsionit kërkon përpjekje kolektive, duke shtuar se zyrtarët duhet të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre. “Sot është një ditë për të reflektuar mbi ndikimin që ka

korrupsioni, ditë për ta rrizotëruar qëllimin për principet e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit. Korrupsioni nuk është vetëm çështje ligjore, por është edhe çështje morale që ul besimin në institucione dhe rrit pabarazinë sociale, sepse lufta kundër korrupsionit kërkon një pjekje kolektive të shoqërisë dhe qeverisë”, ka thënë ai, duke shtuar se Ambasada Britanike përmes projekteve po ndihmon Kosovën në ndërtimin e kulturës dhe transparencës që është baza e llogaridhënies. “Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është thujtë e pamundur pa një shoqëri civile dhe të pavarur dhe pa institucione të forta. Mosndëshkimi bëhet një themel ku ndërtohet korrupsioni. Ne po ndihmojmë institucionet që ta rritin transparencën”, ka pohuar Abbott. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në këtë konferencë ka përmendur sfidat institucionale në raport me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin, paketën ligjore kundër

korrupsionit që ndërlidhet me Ligjin për Agjencinë për Parandalim të Korrupsionit, deklarimin e pasurisë dhe dhuratave, rregulloren për sinjalizim, taskë forcën kundër korrupsionit dhe ekipet e përbashkëta të hetimit në kuadër të ligjit për PSRK-në si dhe Ligjin për Byronë për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme i cili për më shumë se 9 muaj është në shqyrtim nga GjK. “Ndonëse mbetet ende shumë për të bërë, Kosova tashmë po vlerësohet nga indekse ndërkombëtare në përpjekjen e saj për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin”, ka theksuar Haxhiu, duke shtuar se janë bërë më shumë se 32 muaj qeverisjes Kurti dhe, sipas saj, qysh në fillim e kanë pasur prioritet që shkeljet që i kanë gjetur në institucione t'i adresojnë tek institucionet e drejtësisë. “Të gjitha lëndët që i kemi dërguar në prokurori dhe polici mbërrijnë numrin mbi 200. Pra të të gjitha ministrive dhe agjencive. Ajo çfarë kemi vërejtur është mungesa e



# Masë paraburgimi për të dyshuarin e katërt në rastin e vrasjes së Liridonës



PRISHTINË, 11 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar të hënën masë paraburgimi për T. D., i dyshuari i katërt që besohet se lidhet me vrasjen e Liridona Murselit. Në një komunikatë për medie nuk është bërë me dije kohëzgjatja e kësaj mase.

Liridona është vrarë më 29 nëntor në një fshat afër Prishtinës. Për tre burrat, që dyshohet se janë të përfshirë në vrasje - përfshirë burrin e saj Naim Murselin - gjykata ka vendosur masë të njëjtë paraburgimi ditë më parë. Ditët e fundit është arrestuar i dyshuari i katërt T. D. Sipas një

komunikatë të lëshuar nga gjykata, i pandehuri dyshohet që nëse gjendet në liri, mund të ndikojë te të dëmtuarit dhe në dëshmitarë. Ai besohet se më 29 nëntor, rreth orës 14:00, në vendin e tij të punës, dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, ua ka shitur armën N.

M dhe G. P., e cila më pas dyshohet se është përdorur për kryerje të vrasjes. Vrasja e Liridonës është dënuar ashpër nga autoritetet në Kosovë dhe është bërë thirrje për drejtësi. Zemërim të shtuar ka shkaktuar fakti se dyshohet që vrasja është kryer në prani të dy fëmijëve të

## 55 gra të vrara në 13 vjet

Nga viti 2010 deri në nëntorin e vitit 2023 në Kosovë janë vrarë 55 gra. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në disa raste kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Në të shumtën e rasteve autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

Liridonës.

Trupi i saj është zhvarrosur disa ditë pas varrimit për t'u rivarrosur te varrezat e familjes së saj. Vetëm këtë vit në Kosovë janë vrarë katër gra. Në periudhën janar-nëntor në këtë vend janë raportuar rreth 2 000 raste të dhunës në familje. Sipas ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, 90 për qind e viktimave të kësaj dhune kanë qenë gratë dhe vajzat.

## Bislimi: Kontrata 'Elektrosever'-KEDS është hap drejt normalizimit të furnizimit me rrymë në veri

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, e quajti të hënën nënshkrimin e kontratës mes "Elektrosever"-it dhe kompanisë së Kosovës për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike (KEDS), një hap tjetër drejt normalizimit të furnizimit me rrymë dhe lëshimit të faturave për qytetarët në katër komunat me shumicë serbe në veriun e Kosovës.

Të shtunën i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, njoftoi për nënshkrimin e kontratës mes kompanisë serbe dhe KEDS-it. "Operimi edhe në veri do të ndodhë brenda kornizës ligjore e rregullative të Republikës së Kosovës në të gjithë territorin e vendit tonë", shkroi Bislimi të hënën në rrjetin social "Facebook".

Më 21 qershor Kosova dhe Serbia e nënshkruan udhërrëfyesin për zbatimin e Marrëveshjes për Energji, që ishte arritur më 2013 në



kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja.

"Elektrosever" është pronë e kompanisë energjetike të Serbisë EPS (Elektroprivreda Srbije). Ajo e mori licencën për operim nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE) më 24 qershor. "Më shumë se 1 vit pas dakordimit mbi udhërrëfyesin e pasi që pala jonë i përmbushi menjëherë obligimet e saj që derivojnë nga marrëveshja, 'Elektrosever' pranoi ta nënshkruajë kontratën", tha Bislimi.

Ky udhërrëfyes nuk është zbatuar deri tani dhe Bislimi tha se tani është koha "të ecet tutje edhe me hapat e tjerë të nevojshëm për t'i dhënë fund pas më shumë se 20 vjetëve ilegalitetit në mospagesë të rrymës". Qytetarët e katër komunave në veriun e Kosovës nuk kanë paguar për rrymën e shpenzuar që prej vitit 1999. Përgjatë viteve borxhi i tyre është paguar nga qytetarët e komunave të tjera të Kosovës dhe që nga viti 2017 nga Qeveria e Kosovës.

veprimeve nga ana e institucioneve të drejtësisë në raport me rastet të cilat i kemi dërguar. Nuk di nëse ka këtu prezentë prokurorë, megjithatë konsideroj se ky është një problem serioz, sepse kur një institucion e dërgon një lëndë në prokurori dhe kur prokuroria fle, nuk e trajton, atëherë kemi probleme serioze në këtë drejtim", ka thënë ministrja

Haxhiu. Ajo ka thënë se do të vazhdojë t'i japë kritika sistemit të drejtësisë pavarësisht se ka pasur akuza se me deklarata si ministre po ndërhyjnë në drejtësi. Komisionarja për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dermaku, ka theksuar se agjencia që drejton shtyllë kryesore ka mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në qasjen e dokumenteve publike. Ajo ka

treguar se nga qershori i vitit 2021 kanë pranuar 143 ankesa të qytetarëve, kryesisht nga shoqëria civile. "Ankesat dhe natyra e tyre kanë qenë nga më të ndryshmet, por kryesisht në numrin më të madh kanë qenë për procedurat e rekrutimit të prokurimit", ka deklaruar Sogojeva-Dermaku, duke shtuar se kjo agjenci në vitin 2022 ka pranuar 421 ankesa.

"Numri i tyre deri në shtator 2023 ka shkuar deri në 500", ka thënë ajo. Sogojeva-Dermaku ka thënë se për dallim që në vitin 2021 ka pasur më shumë ankesa nga shoqëria civile, në vitin 2022 dhe 2023 numri i ankesave tashmë është më i madh nga qytetarët. Ndërkaq drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Ylli Buleshkaj, u shpreh i bindur se

bashkëpunimi ndërinstitucional është bazë për luftimin e korrupsionit. "Po sfidohe mi nga korrupsioni që ndikon në shoqëri dhe në institucione duke gërryer gjëra të tjera. Shoqëria ka treguar se kurdo që është sfiduar ka dalë edhe më e fuqishme, andaj edhe unë shpresoj se nga kjo sfidë do të dalim më të fuqishëm", ka deklaruar Buleshkaj.



## Për herë të parë në komunën e Prizrenit themelohet Këshilli Publiko-Privat

PRIZREN, 11 DHJETOR - Për herë të parë në komunën e Prizrenit u themelua të hënën Këshilli Publiko-Privat, mbështetur nga aktiviteti i USAID-it - Qeverisja e Pronës. Në kuadër të këtij takimi u tha se komunikimi i vazhdueshëm për sfidat dhe çështjet e ndërlidhura me menaxhimin, dhënien e këmbimin e pronës komunale, partneritetin publiko-privat dhe mbështetjen e

bizneseve me pronare gra, është më se i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit në komunën tonë dhe shërben për krijimin e urave bashkëpunimi mes komunitetit të biznesit dhe pushtetit lokal. "Përmirësimi i ambientit për zhvillimin e biznesit është ndër prioritetet tona, që përkthehet drejtpërdrejt në zhvillim ekonomik të rajonit tonë dhe gjenerim të vendeve të punës", u shpreh me këtë rast kryetari Shaqir Totaj.



## Në Muze të Mitrovicës u hap ekspozita me fotografi 'Gruaja e parë fotografe në Mitrovicë'

MITROVICË, 11 DHJETOR - Në një atmosferë të ngrohtë artistike është hapur ekspozita e fotografisë në Muzeun e Qytetit në Mitrovicë. Kjo ekspozitë paraqet punën e Myzejene Zymit, pionieres së fotografisë në qytetin e Mitrovicës si dhe disa gjenerata fotografësh nga familja Zymi, që kishin atelienë e parë të fotografisë në qytetin e Mitrovicës. Kjo ekspozitë u hap me një fjalë përshëndetëse nga drejtoresha e DKRS-së, Valdete Idrizi, autore e ekspozitës dhe, njëherësh drejtoreshë e Muzeut, Nora Prekazi, Eliza Hoxha - artiste dhe kuratore

e ekspozitës, si dhe në fund një fjalim përshëndetës u mbajt nga vajza e fotografes Mybexhele Zymi Doli. Menaxherja e projektit dhe moderatorja e ngjarjes Fitore Bala Bucaliu e shpalli të hapur ekspozitën duke theksuar se do të jetë e hapur për gjashtë muaj dhe gjatë ekspozitës do të ketë program edukativ që do ta ndihmojë hulumtimin mbi jetën dhe veprën e Myzejene Zymit. Kjo ekspozitë është mbështetur nga: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, DKRS-Mitrovicë, Fondacioni Dhemetra, Mitrovica Guide, SHE-wine.



## Oficerët e FSK-së shkëlqejnë në trajnimet ndërkombëtare në ShBA

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë arritur që me rezultate të larta t'i përfundojnë trajnimet ndërkombëtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke u shpërblyer me çmime "Student më i mirë ndërkombëtar" dhe "Distinguished Honor Graduate/Diplomatic Medal". Nëntoger Betim Osmani ka përfunduar "Kursin Bazik për Oficer të MKAB" ku ka treguar nivel të lartë të aftësive dhe përkushtimit në arritjen e suksesit gjë që e bëri të shpallet "Studenti më i mirë ndërkombëtar", ndërsa nëntoger Florint Fetiu ka përfunduar me sukses

trajnimin "Finance and Comptroller Basic Officer Leader Course" dhe duke vlerësuar lart angazhimin dhe kontributin e tij në këtë fushë u shpërblye me çmimin "Distinguished Honor Graduate/Diplomatic Medal". Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdon të kujdeset për zhvillimin e përkushtuar dhe përmirësimin e aftësive të personelit të saj nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, suksesi i nëntogerëve Osmani dhe Fetiu thekson nivelin dhe përgatitjen e lartë të pjesëtarëve të FSK-së dhe përforcon imazhin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në skenën ndërkombëtare.



## 18 të rinj nga Skenderaj, përfitues të projektit "Komuna për të Rinjtë"

SKENDERAJ, 11 DHJETOR - 18 të rinj kanë përfituar nga projekti i komunës së Skenderajt "Komuna për të Rinjtë". Kryetari i kësaj komune, Fadil Nura, ka nënshkruar kontratat me përfituesit e këtij projekti, duke ua dhënë mundësinë

të realizojnë aktivitete në të mirën e komunitetit. "Në këtë mënyrë po përmbushim zotimet tona që t'i përkrahim të rinjtë dhe grupet e tyre në idetë inovative", ka shkruar Nura në "Facebook".

## Latifi nënshkruan memorandumin "Bëhu partneri im për mirëqenie"

RAHOVEC, 11 DHJETOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me drejtorin ekzekutiv të OJQ "Advancing Together (AT)", Bashkim Ibishi, kanë nënshkruar

memorandum bashkëpunimi për zbatimin e projektit "Bëhu partneri im për mirëqenie", që ka për qëllim fuqizimin e komuniteteve lokale, duke kontribuar në hartimin,

zbatimin dhe monitorimin e planeve dhe projekteve në lidhje me komunitetet. "Këto projekte ofrojnë një nxitje për anëtarët e komuniteteve joshumicë dhe autoritetet

lokale. Andaj ne si komunë mbetemi të përkushtuar për fuqizimin dhe mbështetjen e tyre në mënyrë që të rritet mirëqenia", ka thënë pas nënshkrimit kryetari Latifi.





# KMDLNj: Kosova pa krijuar qëndrueshmëri politike dhe ekonomike s'mund të flasë për respektim të të drejtave të njeriut

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Më 10 dhjetor 1948 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e miratoi Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut që u ratifikua nga pjesa dërrmuese e anëtarëve të OKB-së sikur që u bë pjesë përbërëse e kushtetutave të atyre vendeve që morën detyrim zbatimin e saj.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se Kosova është rrush prej dokumenteve për të drejtat e njeriut, por se mundësitë që ato të realizohen në mënyrë efektive janë të kufizuara nga situata politike dhe mundësitë materiale. "Kësaj radhe rastisi që Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut ishte në ditë pushimi (e diel), prandaj edhe deklaratat e politikanëve ishin deklarata të vikendit, thuaja të përgjumura dhe pa asnjë peshë relevante. Realisht, në Kosovë nuk ka asnjë arsye që të festohet kjo ditë, por se kalendari i datave detyron protokollin e shtetit që ta shënojë këtë ditë", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, në planin politik qytetarët e Kosovës janë të privuar nga e drejta elementare e njeriut të informohen për bisedimet me Serbinë dhe të bëhen aksionarë të këtyre bisedimeve që e përcakton ardhmërinë e tyre. "Ndodh pikërisht e kundërta; në një proces krejtësisht jotransparent, të mbyllur dhe të privatizuar nga një grusht politikanësh të papërgjegjshëm, qytetarët vendosen para aktit të kryer duke u informuar vetëm për rezultatit final të marrëveshjeve. Kjo nënkupton se të drejtat politike dhunohen në mënyrë të pashembullt. Kuvendi i Kosovës ka dështuar plotësisht në përmbushjen e agjendës sikur që dhunohet vullneti i deputetëve duke u detyruar të



votohen ligjet e caktuara. Për arsye të paqarta nuk u realizuar procesi i regjistrimit të popullsisë në këtë vit. Ka ndërhyrje flagrante të qeverisë në punën e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës", thuhet në këtë komunikatë.

KMDLNj ka theksuar se mediet iu nënshtrohen kërcënimeve nga individë të fuqishëm të politikës, por edhe nga institucionet. "Neptizmi është bërë thuaja gjithëpërfshirës duke e 'zëvendësuar' institucionin e konkursit. Korrupsioni ka prekur majat më të larta të pushtetit, po mirëmbahet dhe po mbrohet nga pushteti. Dhuna është në rritje, në përgjithësi sikur ajo ndaj femrave, në veçanti. Lëmosha është bërë 'vend pune' për shumë fëmijë sikur edhe bërthamë e kriminit të organizuar", bëhet me dije në komunikatën e KMDLNj-së, duke shtuar se në Kosovë është i theksuar diskriminimi në baza

etnike si në asnjë vend në Evropë. "Qytetarët serbë (dhe pakicat tjera) në veri të Kosovës, që nga përfundimi i luftës nuk paguajnë faturat për rrymë, tatim në pronë, ujë, mbeturina dhe shërbime tjera në ndërkohë që shqiptarët dhe të tjerët për 30 euro borxh dërgohen te përmbaruesi, madje edhe pensionistët dhe kategoritë e përfituesve nga skema sociale". KMDLNj në vazhdim të kësaj komunikate ka reaguar edhe për ish-udhëheqësit e UÇK-së që po mbahen në paraburgim nga Gjykata Speciale në Hagë. "Shtetasit e Kosovës, të gjithë shqiptarë po mbahen peng nga një Gjykatë Speciale Raciste ku po dënohen me dënime drakonike, iu shkelen të drejtat e njeriut sikur që paramilitarët politikë dhe policorë të burokratëve evropianë thuaj çdo ditë dhunojnë familjet shqiptare duke i bastisur, duke iu konfiskuar telefona dhe pajisje tjera dhe duke i mbajtur peng për një kohë të gjatë. Krejt kjo

ndodhë në një vend që deklarohet si i pavarur dhe sovran. Po legalizohen sisteme paralele në fushën e Gjyqësorit (përmes Gjykatës Speciale), sisteme paralele të burgjeve (ai i Kosovës dhe ai i Danimarkës), sisteme në fushën e energjisë përmes KEDS-it dhe Elektroseverit (nga Serbia), sisteme në fushën e arsimit, shëndetësisë, ekonomisë, sigurisë etj", është thënë në këtë komunikatë të KMDLNj-së.

Tutje thuhet se për dallim nga shtetet e rajonit në tre vitet e fundit pensionistët nuk kanë përfituar asnjë rritje përveç 10 eurove për pensionistët e moshës dhe 200 euro për pensionet e rregullta që pjesëtuar për 36 muaj i bie se kanë fituar 5.5 euro në muaj. "Mezerie. Kategoritë sociale kanë qenë përfitues të 'vitrave qeveritare' dhe asgjë tjetër. Gjendja në arsim dhe shëndetësi është buzë kolapsit, është në vdekje klinike. Migrimi i të rinjve jashtë vendit është në shifra alarmante prandaj

kjo edhe ka qenë arsyeja pse nuk është bërë regjistrimi i popullsisë. Nga këto që u përmenden më lart ka të trashëguara nga qeveritë paraprake por se një numër i konsiderueshëm mbanë autorësinë e qeverisë aktuale", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së, duke theksuar se të gjitha këto që u listuan e bëjnë të padenjë Qeverinë e Kosovës të flasë për promovim të drejtave të njeriut për faktin se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për mbrojtje të këtyre të drejtave përveç deklaratave politike, pa peshë dhe pa përmbajtje. "Të drejtat e njeriut në Kosovë nuk janë në ditët e mira, për to prandaj jo që nuk ka asnjë arsye të festojmë dhe të krenohemi me to, por edhe shënimi i kësaj dite po bëhet thuaja ilegalisht. Kosova, pa krijuar qëndrueshmëri politike dhe ekonomike e ka të pamundur të flasë për respektim të drejtave të njeriut, qoftë kjo qeveri apo ajo që do të jetë e radhës", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

## Kurti në Kongresin e SPD-së në Gjermani: Kosova, shtet i së drejtës dhe barazisë për të gjithë

BERLIN, 11 DHJETOR - Në vizitën e radhës zyrtare në Berlin, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryeministër i vendit, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Kulturës, Hajrulla Çeku dhe nënkryetaren e dytë të Lëvizjes Vetëvendosje, Mrika Limani-Myrtaj, morën pjesë në Kongresin e Partisë Socialdemokrate të Gjermanisë - SPD-së.

Kurti ka treguar se në margjinat e këtij kongresi ka takuar kancelarin gjerman Olaf Scholz, ku, sipas tij, u dëshmuar marrëdhëniet e

forta dhe të shkëlqyeshme dypalëshe dhe vizioni i përbashkët si socialdemokrat për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies në të dy vendet. "Fuqizimi i bashkëpunimit brenda familjes politike të spektrit të majtë socialdemokrat ishte fokus i bisedës dhe me Sekretaren e Përgjithshme të Internacionales Socialiste, Benedicte Lasi, si dhe me kryetarin e SPD-së, njëkohësisht deputet i Bundestagut gjerman, Lars Klingbeil. Kosova është shtet i së drejtës, demokracisë e

barazisë për të gjithë. Biseduam dhe rreth dinamikës e situatës në rajonin e Ballkanit Perëndimor, procesin e dialogut e përkushtimin e Kosovës drejt integritimit evropian", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Ai ka theksuar se nuk mund të mungonte takimi me mërgatën, ku biseduan mbi një mori temash. "I interesuar jo vetëm për t'i informuar me ecurinë e aktualitetin e vendit tonë, por edhe për të dëgjuar rreth jetës e përvojës së tyre, përshtypjeve e ideve të diasporës", ka shkruar Kurti.





## Ambasadorët e huaj mirëpresin arritjen e marrëveshjes mes KEDS-it dhe "Elektrosever"-it për energjinë në veri

PRISHTINË, 11 DHJETOR - KEDS-i dhe "Elektrosever"-i, së fundmi kanë arritur marrëveshje për normalizimin e shpërndarjes dhe të furnizimit me energji elektrike në pjesën veriore të Kosovës.

Arritjen e kësaj marrëveshjeje e kanë mirëpritur ambasadorët e huaj të akredituar në Kosovë.

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka shkruar në rrjetet sociale se

ky është një lajm i mirë dhe se tani duhet të ketë zbatim pa vonesa. "Vërtet lajm i mirë, tani kemi nevojë për zbatim të qëndrueshëm pa vonesa të mëtejshme!", është shprehur Rohde.

Edhe ambasadori i Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott, e ka quajtur të rëndësishme arritjen e kësaj marrëveshjeje. "Unë e mirëpres këtë progres të rëndësishëm në

zbatimin e udhërrëfyesit të energjisë", ka shkruar ai.

Edhe Bashkimi Evropian ditë më parë e ka mirëpritur nënshkrimin e kontratës komerciale ndërmjet kompanisë energjetike të Kosovës KEDS dhe kompanisë "Elektrosever". Miroslav Lajçak me anë të një komunikate e ka quajtur këtë hap të rëndësishëm për zbatimin e plotë të Udhërrëfyesit për Energjinë.



## Ngrohtorja solare, MFPT dhe 'Termokos'-i nënshkruajnë marrëveshje 80 milionë euro

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe kryeshefi ekzekutiv i "Termokos"-it, Fisnik Osmani, kanë nënshkruar tri marrëveshje për ndërtimin e ngrohtores diellore në Prishtinë. Në ceremoninë e nënshkrimit ishin edhe ambasadori gjerman në Kosovë, drejtori në Bankën për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), shefi për bashkëpunim në Zyrën e BE-së në Kosovë dhe kryetari i komunës së Prishtinës.

Ndërtimi i ngrohtores diellore e cila do t'u shërbejë qytetarëve të Prishtinës është bërë e mundur përmes marrëveshjes me BERZH-in me vlerë 23.2 milionë euro, nga KfW 31.6 milionë euro, nga BE-ja grant 21.5 milionë euro dhe kontributi nga qeveria 4.4 milionë euro.

Ky projekt parasheh ndërtimin e një impianti të ngrohjes solare në Prishtinë ku përmes saj do të zgjerohen kapacitetet e prodhimit të energjisë termike të "Termokos"-it deri në 50 MW. Pra, 38 mijë qytetarë që aktualisht nuk janë pjesë e rrjetit të ngrohjes do të fillojnë të kenë qasje në shërbimet e "Termokos"-it pas përfundimit të projektit.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, ministri Murati ka theksuar se ngrohtorja e cila do të ndërtohet është investimi më i madh në rajon sa i përket prodhimit të energjisë termike nga energjia diellore. "Ky projekt mundëson që më shumë qytetarë të kenë



ngrohje në shtëpitë e tyre me çmim më të volitshëm dhe në të njëjtën kohë ndikon në përmirësimin e cilësisë së ajrit", është shprehur Murati.

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, ka falënderuar ministrin Murati për bashkëpunimin e deritanishëm duke shprehur se ngrohtorja diellore e qytetit ofron kapacitet të shtuar të ngrohjes dhe se ndërtimi i ngrohtores bëhet pikërisht në një kohë vendimtare për tranzicionin e gjelbër energjetik në Kosovë.

Përfaqësuesi i BERZH-it, Sergiy Maslichenko, ka theksuar se ky projekt do të lidhë me shumë ndërtesa me ngrohtoren e qytetit dhe se është shembulli më i mirë i bashkëpunimit në mes të aktorëve të ndryshëm.

Në anën e tij, përfaqësuesi i BE-së, Johannes Madsen Stenbaek, ka theksuar se me një investim prej 80 milionë eurosh nga EU, BERZH-i, KfW, dhe institucionet e Kosovës, ky projekt ndryshon paradigmen e prodhimit të energjisë në Kosovë pasi po bëjnë

një ndryshim të rëndësishëm drejt energjisë më të pastër dhe të volitshme për të gjithë qytetarët. Në anën tjetër, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka përhëndetur punën e deritanishme duke thënë se "nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve është një moment historik për Prishtinën sepse garantohet fuqizimi i komunitetit dhe nxitet rritja ekonomike".

Së fundmi, kryeshefi ekzekutiv i "Termokos"-it, Fisnik Osmani, ka falënderuar ministrin Murati dhe

partnerët ndërkombëtarë për përkrahjen në avancimin e shërbimeve të ofruara nga Ngrohtorja e Qytetit të Prishtinës "Termokos", duke theksuar se ky projekt është projekti më i madh i energjisë termike në Kosovë i cili do të sigurojë ngrohje të qëndrueshme dhe të përbalueshme për qytetarët e Prishtinës.

Të gjitha palët u shprehën të gatshme ta thellojnë bashkëpunimin në fushën e energjisë dhe në projekte të tjera të përbashkëta.

## Hoti: Ambienti për biznes në vitin 2023 është përkeqësuar

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se ambienti për biznes në vitin 2023 është përkeqësuar në të gjitha aspektet krahasuar me vitin 2017. "Të gjithë treguesit, pa asnjë përjashtim, janë përkeqësuar. Migrimi i fuqisë

punëtore ka dalë të jetë pengesa kryesore. Shqetësues është përkeqësimi sa iu përket shërbimeve të Administratës Tatimore dhe Administratës Doganore. Edhe perceptimi për korrupsionin është rritur", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka thënë se qasja në kredi dhe kostoja e financimit janë përkeqësuar

gjithashtu. "Sigurimi i lëndës së parë është bërë dukshëm më i vështirë. Interesant është e gjetura se qasja në informacion për ndërmarrjen gati është dyfishuar si pengesë. Në këtë ambient për biznes, natyrshëm se rritja ekonomike bie në nivele shumë të ulëta", ka theksuar Hoti.





# Rrjeti i ri i narkotrafikantëve



Në një nga ditët e fundit të tetorit, 90 policë, 22 automjete dhe një top uji qëndronin gati në një fushë në periferi të Santiagos, kryeqyteti i Kilit. Nuk ishin aty për të mbajtur rendin në një protestë të zhurmshme. Ishin për të monitoruar varrimin e një gruaje të re me lidhje të dyshuara me trafikantët e drogës. Një ngjarje e tillë, e cila zakonisht përfundon me plumba të qëlluar në ajër nga vajtuesit, dikur do të ishte e pamendueshme në Kili, i konsideruar prej kohësh si një nga vendet më të sigurta të Amerikës Latine. Por midis majit 2019 dhe shtatorit 2023, bandat mbajtën afro 2000 funerale të tilla, sipas Gabriel Boric, presidenti i vendit. Në shtator, Boric i dërgoi një projekt-ligj Kongresit për t'i kufizuar ato.

Harta e vrasjeve në Amerikën Latine po reduktohet. Shkalla e vrasjeve në rajon ka rënë që nga viti 2017, megjithëse vende të tilla si Meksika dhe Brazili janë ende qendra e disa prej qyteteve me shkallën më të lartë të vrasjeve në Tokë. Por në vendet dikur të sigurta, shkalla e vrasjeve po arrin nivele rekord, duke përfshirë Ekuadorin, Kosta Rikën dhe Kilin.

Quajeni rrjeti i ri i narkotikëve: një koktej droge, armësh dhe migrimi po nxit dhunën e bandave në të gjithë rajonin. Marrim së pari Ekuadorin. Zhytja e tij në kaos ka qenë e shpejtë. Në vitin 2018, vendi ishte një zonë e përgjumur e Andeve, prej 17 milionë banorësh. Eksportonte vaj dhe peshk. Ai kishte shkallën e katërt më të ulët të vrasjeve në Amerikën Latine, me 5.8 për 100,000 banorë. Por këtë vit kjo normë pritet të arrijë në 35 për 100,000 banorë. Është gati më i lartë se ai i Meksikës dhe i Brazilit. Grupet kriminale vrasin pa u ndëshkuar,

duke vendosur makina bomba dhe duke varur trupa të pajetë nga urat. Në gusht, një kandidat presidencial që konkurronte me një platformë kundër korrupsionit u vra.

Kokaina është shkaktari kryesor i problemeve të Ekuador. Për disa dekada, vendi u injorua nga trafikantët ndërkombëtarë të drogës. Kjo ndryshoi në fund të viteve 2000, kur bandat kuptuan se mund të merrnin përfitime edhe më të mëdha duke dërguar ngarkesa më larg, në Evropë dhe Australi. Pjesërisht si rezultat i kësaj, bandat më pas ndryshuan metodat e transportit: në vend që ta paketonin atë në avionë ose varka për në Shtetet e Bashkuara, kokaina nisi të shpërndahej brenda anijeve me kontejnerë midis mallrave legjitime.

Pasi portet kolumbiane forcan masat e sigurisë, kriminelët kërkuar rrugë alternative të transportit. Portet e Ekuadorit, të monitoruara dobët u bënë edhe më tërheqës pas vitit 2009, kur Rafael Correa, i krahut të majtë, më pas president, minoi mbrojtjen e vendit duke mbyllur një bazë detare amerikane dhe duke i dhënë fund kështu, bashkëpunimit me DEA-n. Bandat ekuadoriane si Los Choneros nisën të lëvizin kokainën për bandat meksikane dhe mafien shqiptare. Deri në vitin 2019 Ekuadori ishte kthyer në superautostradë e kokainës.

Burgosja e gangsterëve thjesht i ndihmoi ata të forconin rrjetet. Los Choneros lulëzoi në burgjet e mbushura me njerëz, duke rekrutuar shumë dhe duke organizuar sulme ndaj armiqve. Vrasjet e targetuara u përshkallëzuan në masakra, ku dhjetëra të burgosur u copëtuan dhe u dogjën. Në vitin 2021, 330 të burgosur u vranë në Ekuador, numri më i madh në botë. Po atë vit,

kokaina rregjistrohej si eksporti i gjashtë më i madh në vend.

Po ashtu, këtë vit në Kosta Rika, viktimat mes njerëzve parashikohen të arrijnë një rekord prej 17 për 100,000 banorë, krahasuar me 11 për 100,000 banorë tre vjet më parë. Kokaina është gjithashtu një pjesë e madhe e problemit. Rritja e prodhimit në Kolumbi, ku janë korrur sasi rekord të gjetheve të kokës në vitet e fundit, përkthehet në anije më të mëdha që mbërrijnë në Kosta Rika, thotë Alvaro Ramos, ish-ministër i sigurisë.

Megjithatë, koka nuk është e vetmja arsye për rritjen e dhunës. Vitet e fundit, shumë vrasje kanë qenë për tregun vendas të marijuanës. Kanabisi i paligjshëm është një biznes i madh në Kosta Rika: 3% e banorëve thonë se e përdorin çdo muaj, një nga normat më të larta të konsumit në Amerikën Qendrore. Shumë banda preferojnë barin, se sa kokainën. Lëvizja e të bardhës është e vështirë: kërkon lidhje dhe zyrtarë të korruptuar (nga të cilët ka relativisht pak në Kosta Rika). Në të kundërt, bari ka pak pengesa për hyrjen dhe mund të shitet kudo.

Shteti është i pajisur dobët për të ndaluar lulëzimin e këtyre bandave të reja. Kosta Rika hoqi ushtrinë e saj në vitin 1949. Rodrigo Chaves, presidenti i vendit, fajëson administratën e kaluar dhe gjyqësorin për situatën. Ai thotë se vendi nuk ka polici të mjaftueshme, ligjet janë të vjetruara dhe sistemi gjyqësor është shumë i butë ndaj kriminelëve.

Vendi i tretë në këtë situatë të re të narko-rrjetit, Kili, nuk është një pikë e nxehtë vrasjesh. Vitin e kaluar shkalla e vrasjeve aty, arriti një rekord 6.7 për 100,000 banorë. Kjo është shumë më poshtë se fqinjët dhe afër normës në Shtetet e

Bashkuara, prej 6.3. Por siç dëshmojnë narkofuneralet, krimi po përkeqësohet shumë. Më shumë kokainë dhe kanabis po ndalohen se kurrë më parë, me konfiskimet e kanabisit që janë trefishuar midis 2018 dhe 2021. Portet e tij janë bërë objektiva të atentatorëve. Trafikimi i lëndës drusore është gjithashtu problem. Industria e bakrit, e cila përbën gati 11% të GDP të vendit, është goditur nga rrëmbimet e armatosura.

## Blues kokaine

Kili është një nga vendet më të pasura të rajonit. Ai gjithashtu pret gjysmë milionë emigrantë nga Venezuela, të cilët ikin nga regjimi i Nicolas Maduros. Ky kombinim ka tërhequr mafia si Tren de Aragua, banda më e madhe e Venezuelës. Ajo po lufton për të kontrolluar botën e kriminit të Kilit, duke ndërtuar një perandori të trafikut njerëzor në të gjithë Amerikën e Jugut. Të shtëna me armë zjarri ndodhin rregullisht në qytetin port të Iquiques, pasi bandat lokale i shmangin sulmet nga venezuelianët.

Celulat e Tren de Aragua-s drejtojnë unaza prostitucioni në disa qytete. Rreth 40 anëtarë të dyshuar u burgosën në një provincë vitin e kaluar. Dhjetëra janë arrestuar në bastisjet e policisë këtë vit. Si rezultat, pjesa e kilianëve që thonë se imigrimi është i keq është rritur nga 31% në dhjetor 2018 në 77% në prill 2023, sipas Cadem, një anketues. Një tjetër sondazh zbuloi se shumica fajësojnë emigracionin e paligjshëm për rritjen e kriminit. Duke u përballur me zgjedhjet rajonale vitin e ardhshëm, qeveria është fokusuar më shumë te siguria. Pasi tre oficerë policie u vranë në mars, z. Boric u zotua për një rritje

vjetore prej 40% në buxhetin e sigurisë dhe miratoi ligje më të rrepta ndëshkuese për krimet ndaj policisë. Megjithatë, shumë e konsiderojnë atë shumë të butë ndaj kriminit.

Çfarë do të thotë ky rrjet i ri narkotrafikantësh për vendet që dikur ishin ndër historitë e suksesit të Amerikës Latine? Shumë qytetarë do të votojnë me këmbë. Vitin e kaluar, ekuadorianët ishin kombësia e dytë më e madhe që kaluan shtegun Darien të Panamasë në rrugën e tyre drejt veriut.

Ata që qëndrojnë në shtëpi mund t'i drejtohen zgjidhjeve më ekstreme. Sipas Latino bar 6 metro, një kompani rajonale sondazhesh, plot 48% e ekuadorianëve, 31% e kilianëve dhe 22% e kostarikanëve e renditin sigurinë si problemin më të madh të vendit të tyre, shumë mbi mesataren rajonale prej 13%.

Shumë latino-amerikanë e admirojnë presidentin autoritar të El Salvadorit, Nayib Bukele, i cili gjatë viteve të kaluara ka burgosur 1.6% të popullatës në një goditje gjithëpërfshirëse të bandave dhe mbështetja për të është 88%, më e larta në rajon.

Politikanët në të gjithë Amerikën Latine po mbajnë shënim. Më 15 tetor Daniel Noboa, një 35-vjeçar i djathtë, fitoi zgjedhjet presidenciale në Ekuador. Ai ka premtuar të pranojë qasjen e z. Bukele dhe të ndërtojë burgje lundruese në Paqësor. Disa janë skeptikë se do të frenojnë problemin e bandave atje. Por zgjidhje të tilla të çuditshme janë gjithnjë e më popullore. Përballë bandave gjithnjë e më të fuqishme, shumë amerikano-latinë mendojnë se sakrificimi i të drejtave civile është një çmim që ia vlen të paguhet për sigurinë.

*The economist (bota.al)*



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Hajrizi, MVP i javës në Superligën e basketbollit

**MIRTOVICË, 11 DHJETOR** - Basketbollisti i Trepçës, Drilon Hajrizi, ka zhvilluar një tjetër paraqitje të mirë në këtë edicion. Hajrizi ishte më i miri i mitrovicasve në sfidën kundër Proton Cable Prizrenit. Basketbollisti i Kosovës kishte 22 pikë e 13 kërcime, gjashtë asistime, si

dhe dy topa të vjedhur dhe dy bllokada, duke e pasur indeksin e ndeshjes 41, apo më të lartën për këtë xhiro, si dhe njërin nga më të lartët në këtë edicion për mitrovicasin. Peja pa shumë probleme fitoi kundër Istogut, ndërsa më i dalluari ishte edhe kësaj radhe Justin

Davis, me 29 pikë, nëntë kërcime, pesë asistime, duke e pasur indeksin 39. Indeksin e lartë e kishte edhe Jalen Nesbitt (35) i Golden Eagle Yllit në sfidën kundër Vëllaznimit. Nesbitt e mbylli ndeshjen me 23 pikë, tetë kërcime dhe dy asistime. Sigal Prishtina fitoi derbin e

rivalëve të vjetër kundër Bashkimit, ku u dalluan dyshja vendore Fisnik Rugova dhe Dardan Berisha. Rugova e përfundoi ndeshjen me 18 pikë, 11 kërcime dhe dy asistime, ndërsa Berisha me 22 pikë, tri kërcime dhe gjashtë asistime.



## Hyseni për herë të tretë 'Ylli i javës': 'Legjendave' u premtoj shumë gola

**PODUJEVË, 11 DHJETOR** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës Albi Mall vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 17-të në Albi Mall Superligë i ka takuar për herë të tretë futbollistit të KF Llapi, Muhamet Hyseni. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Idriz Elezaj, Fisnik Ademi dhe Flamur Sinani. Ky komision vlerësoi që Hyseni e meriton epitetin e më

të mirit të javës, duke shënuar dy gola dhe një asistim si dhe nxori penalltinë në një ndeshje të rëndësishme në të cilën Llapi e mposhti kampionin në fuqi, FC Ballkani. Pasi mori këtë çmim Muhamet Hyseni u shpreh i lumtur për fitoren dhe për vlerësimin si më i miri i xhiros. "Ta pranosh çmimin 'Ylli i javës' për herë të tretë brenda 17 xhiros është ndjenjë fantastike. Rol të madh që unë po pranoj këtë çmim kanë të gjithë ata që më mbështesin

pareshitur, duke filluar nga bashkëlojtarët, trajnerët dhe tifozët. Pa mbështetjen e tyre nuk do ta kisha këtë sezon kaq të mirë. Ndeshja e fundit ndaj Ballkanit ishte shumë e vështirë, por besoj që me angazhimin e gjithë secilit futbollist arritëm fitore të merituar. Tifozëve tanë 'Legjendave' u premtoj ende gola dhe paraqitje sa më të mira në mënyrë që së bashku t'i arrijmë objektivat e klubit", ka thënë Muhamet Hyseni për faqen zyrtare të FFK-së.



## 'Uta: Ngjitja për Kosovën', publikohet dokumentari frymëzues i Uta Ibrahimit



**PRISHTINË, 11 DHJETOR** - Uta Ibrahim ka bërë me dije se është publikuar një dokumentar rreth karrierës së saj në alpinizëm, i quajtur "Uta: Ngjitja për Kosovën". Përtej shfaqjes së ngjitjes së saj nëpër pikat më të larta në botë, dokumentari hedh dritë mbi punën e palodhur që ka bërë për Kosovën, duke u përpjekur t'i frymëzojë të rinjtë që t'i ndjekin ëndrrat e tyre pavarësisht prej sfidave me të cilat përballen. Kjo nuk është vetëm një histori ngjitjeje malore sipas Utës. Ajo ka të bëjë me tejkalimin e fatkeqësive, gjetjen e forcës në rrënjët e dikujt dhe nxitjen e një shpirti vendosmërie te gjeneratat e ardhshme. "Në

Ditën Ndërkombëtare të Maleve jam e emocionuar të ndaj me ju dokumentarin 'Uta-Ngjitja për Kosovën' dhe ju ftoj ta ndiqni në rehatinë e shtëpive dhe ekraneve tuaja. Ky film lundroi thellë në përvojat e mia të fëmijërisë gjatë luftës në Kosovë dhe arriti ta sintetizojë gjithë kujtimin e veprimtarinë në aktin tim final. E gjithë kjo çon në udhëtimin tim për ta sjellë flamurin e Kosovës në majën e botës - Everest. Përtej shfaqjes së ngjitjes sime personale, dokumentari hedh dritë mbi punën e palodhur që kam bërë në Kosovë, duke u përpjekur t'i frymëzojë të rinjtë që t'i ndjekin ëndrrat e tyre pavarësisht prej sfidave me të

cilat përballen", ka thënë Uta Ibrahim. "Kjo nuk është vetëm një histori ngjitjeje malore. Ka të bëjë me tejkalimin e fatkeqësive, gjetjen e forcës në rrënjët e dikujt dhe nxitjen e një shpirti vendosmërie te gjeneratat e ardhshme. Bashkohuni me mua në këtë udhëtim duke eksploruar majat e triumfeve personale dhe luginat e betejave të përbashkëta. 'Uta: Ngjitja për Kosovën' është një dëshmi e shpirtit të paepur njerëzor dhe besimit se çdo majë është e arritshme. Le të festojmë dhe frymëzojmë ndryshimin dhe ta inkurajojmë brezin e ardhshëm të ngjitet në Everestin e vet", ka shtuar Uta Ibrahim.

## Ferizaj, kampion vjeshtor në Superligën e Femrave

**FERIZAJ, 11 DHJETOR** - Me ndeshjet e zhvilluara të dielën ka përfunduar stinori vjeshtor në Superligën e Kosovës në hendboll (femrat). Janë luajtur 11 xhiro deri më tani, ndërsa kampion vjeshtor është Ferizaj. Skuadra nga qyteti i hendbollit ka fituar të gjitha 11 ndeshjet dhe udhëheq me 22 pikë. Në vendin e dytë është Istogu me 20 pikë. Pra humbjen e vetme

kampioni aktual, Istogu, e ka nga Ferizaj. Pason Samadrexha me 18 pikë, ndërsa më prapa kanë mbetur Vushtrria e Shqiponja me nga 12 pikë. Ferizaj gjatë verës u konsolidua. Bëri përforcime të shumta, rriti nivelin e punës dhe kështu rreshtoi fitoret në kampionat. Shenjat e para i dha në ndeshjen për Superkupë, të cilën e humbi nga Istogu. Por luajti ndeshje të

fortë dhe dëshmoi se ka synime. Ferizajaset i kanë shënuar 481 gola, ndërsa kanë pranuar 226. Kanë sulmin më efikas, po ashtu mbrojtjen më të fortë. Istogu ka shënuar 422 gola, ndërsa ka pranuar 266. Stinori vjeshtor në Superligën e hendbollisteve ishte interesant. Gara e zhvilluar deri më tani premtonte garë shumë të fortë për titull të kampionit.





## Ibra pas rikthimit te Milani: Dashuria ime për kuqezinjtë nuk do të mbarojë kurrë

MILANO, 11 DHJETOR - Tashmë është konfirmuar edhe nga klubi i Milanit, se Zlatan Ibrahimoviçi është rikthyer me një rol si këshilltari i lartë dhe kryesor i pronësisë së Milanit. Skuadra kuqezi i ka

kushtuar një tekst të gjerë Ibras duke lartësuar figurën e tij profesionale ndër vite dhe aftësitë e tij brenda dhe jashtë fushës. “Të jesh pjesë e së ardhmes së Milanit është diçka që vetëm mund ta kisha

ëndërruar. Dashuria ime për kuqezinjtë nuk do të mbarojë kurrë. Jam jashtëzakonisht mirënjohës që u bashkohen kompanisë ‘RedBird’ dhe klubit të Milan në këto role të rëndësishme me ndikim.

Pres me padurim të kontribuoj në aktivitetet e investimit të pronave të tyre në sport, media dhe argëtim. I jam mirënjohës Gerryt që më ka vënë në dispozicion këtë mundësi”, është shprehur Ibra.



## Tare: Nga Lazio nuk u largova për shkak të Sarrit

ROMË, 11 DHJETOR - Intervistë e gjatë e dhënë për “Corriere della Sera” nga Igli Tare, ish-drejtori sportiv i Lazios, i cili pas një jete me bardhekaltrit, i ka thënë lamtumirë kryeqytetit në verë, duke u ndarë nga klubi i Lotitos, por që mund të rikthehet së shpejti në aksion, sërish në Serinë A. “Sarri më shtyu t’i jap lamtumirën Lazios? Absolutisht jo. Është shkruar shumë për këtë, por nuk është kështu. Unë fola me Lotiton, pas 18 vjetësh kishte ardhur koha të ndaheshin në mënyrë civile, pa asnjë ndërprerje. Do të kishte qenë e pafalshme për të gjithë. Lazio është në zemrën time, por më duhej të shikoja përreth, të studioja, të njihja realitetet e tjera. Sarri është një integralist, është e vërtetë, dikush që dëshiron t’i bëjë gjërat në mënyrën e tij. Kush e merr trajner, gjithsesi e di që nuk mund ta ndërrojë. Nuk kam debatuar kurrë, por nuk është i lehtë bashkëpunimi me të. Sarri ka mënyrën e tij të konceptimit të futbollit dhe punës. Edhe Lotito i ngjan, një president



me karakter shumë të fortë. Nganjëherë kam vepruar si rrufepritës, kjo është pjesë e punës së një menaxheri të mirë, por martesës sime me Lazion i kishte ardhur fundi. Sarri nuk ka asnjë lidhje me largimin tim nga Lazio. Pas kaq vitesh, ndien nevojën për të parë botë të tjera”, ka thënë Tare. “E ardhmja ime e mundshme te Napoli? Unë nuk jam kontaktuar

nga askush, kështu që përgjigjja ime është jo. Pastaj në futboll gjithçka mund të ndodhë në një çast. Shikoni çfarë ndodhi në kombëtaren italiane: Mançini u largua dhe Spalletti erdhi. Bota jonë është e shpejtë, në zhvillim të vazhdueshëm. Natyrisht që vijnë oferta financiare, por edhe projektet e një klubi. Unë jam duke pritur për ofertën e duhur”, ka shtuar Tare.

## Formula 1, me ndryshime befasues në formatin e garave

MELBOURNE, 11 DHJETOR - Brazili do ta presë fundjavën Sprint për herë të katërt, Austria për herë të tretë, Katari për herë të dytë, Kina dhe Miami do t’i bashkohen për herë të parë. Pistat zgjidhen sipas konfigurimit të tyre, i cili mundëson parakalime dhe gara argëtuese. Që kur u prezantua në vitin 2021, formati Sprint ka pasur një ndikim pozitiv, veçanërisht të premtëve në krahasim me seancat standarde të praktikës, dhe ka sjellë veprime shtesë si për promovuesit ashtu edhe për fansat. Sipas hulumtimeve të kryera në 21 pista, gjatë fundjavës së garave të këtij viti në Azerbajxhan, pati një rritje prej 83-përqindësh të audiencës në kualifikime krahasuar me praktikën e dytë të lirë në 2022, në SHBA ishte 139 për qind dhe në Belgjikë ishte 34 për qind. Gjatë diskutimeve në mbledhjen e Komisionit F1 në nëntor, shumica



mbështeti një propozim për ta ndryshuar Sprint për 2024 për ta “racionalizuar” fundjavën e garës, duke përfshirë ndarjen e

### KALENDARI I FUNDJAVËS SË FORMULA 1 SPRINT PËR 2024:

Kinë, Shanghai	19 - 21 Prill
Miami, Miami	3-5 maj
Austri, Spielberg	28-30 qershor
SHBA, Austin	18-20 tetor
Brazil, Sao Paolo	1-3 nëntor
Katar, Lusail	29 nëntor - 1 dhjetor

aktiviteteve të Sprintit nga aktivitetet e lidhura me Grand Prixin. Komiteti Këshillimor i Sporteve do të punojë për detajet specifike, veçanërisht kur bëhet fjalë për rregulloret e kohës, për të paraqitur një propozim përfundimtar në Komisionin e Formulës 1 në mbledhjen e tij të parë më 2024. Pas këtij takimi do të njoftohen të gjitha ndryshimet e mundshme në Sprint.

### SHKURT

#### Ronaldo: Dua t’i fitoj pesë kampionate me Al Nassrin

Cristiano Ronaldo është zotuar t’i rikthejë ditët e lavdisë tek Al-Nassr, ndërsa skuadra vazhdon luftën për titullin e parë në kampionat që nga viti 2019. Pesë herë fituesi i “Topit të Artë” ka shënuar 39 gola në 46 ndeshje në të gjitha kompeticionet për klubin Saudi Pro League që kur iu bashkua në janar të këtij viti, por fitimi i trofeve është objektivi kryesor për të. Sipas “Sportskeeda”, Ronaldo u është zotuar tifozëve të Al-Nassrit se planifikon të fitojë më shumë se pesë kampionate me ta para se të mendojë të tërhiqet nga futbollit. “Unë nuk do të tërhiqem nga futbollit derisa të arrij më shumë se pesë kampionate me klubin Al-Nassr. Ata kanë tifozët më të mëdhenj në botë. Nuk do t’i harroj kurrë sa të jem gjallë”, citohet të ketë thënë Ronaldo. Al-Nassri aktualisht është i dyti pas Al-Hilalit në renditjen e Ligës Pro Saudite, por Ronaldo është optimist se skuadra e tij mund t’i mposhtë kryesuesit për ta fituar titullin e parë në kampionat në katër vjet.

#### Pas rënies nga kategoria, Santos i pezullon fanellën me numrin e Pelles

Asnjë futbollist i Santos nuk do ta ketë më mundësinë ta veshë fanellën me numrin 10 në sezonin e ri. Këtë fanellë me këtë numër e bëri të famshëm legjenda Pele, teksa ekipi do të garojë në sezonin e ardhshëm në Serinë B, pas rënies nga elita e futbollit brazilian. Dhe për këtë arsye, kryetari i ri i klubit, Marcelo Texeira, ka marrë vendim që në shenjë respekti për Pelen, 10-shi i Santos të mos përdoret deri në rikthimin e ekipit në Serinë A.

#### Xavi pas humbjes nga Girona: Ne luajtëm mirë

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka thënë se skuadra e tij luajti mirë edhe përkundër faktit se humbi në përballje me Gironën (4-2). “Mendoj se ndeshja ishte e barabartë. E vendosën detajet. Na mungoi efektiviteti. Ne luajtëm mirë. Gjuajtëm 30 herë, mund të kishim barazuar 3-3, por jo. Plani i Gironas ishte shumë i guximshëm dhe ata ishin më efikas. Girona ka shumë avantazhe. Është shtatë pikë përpara nesh, dhe puna e Michelit dhe lojtarëve të tij është e mahnitshme. Ndeshja ishte e barabartë. Nëse Barcelona fitonte, do të thoshim se ishte e drejtë. Ne kishim efektivitetin dhe gabimet në mbrojtje ndikuan”, ka thënë Xavi.

#### Beshiktashi përjashton pesë futbollistë

Skuadra e Beshiktashit ka përjashtuar pesë futbollistë nga skuadra para afatit kalimtar të janarit. Beshiktashi ka bërë me dije se arsyeja e përjashtimit të futbollistëve vjen pas paraqitjeve të dobëta të tyre. Vincent Aboubakar, Valentin Rosier, Eric Bailly, Rachid Ghezzal dhe Jean Onana janë futbollistët e përjashtuar nga skuadra e Besiktashit. “Informacion nga klubi ynë: 5 lojtarë nga ekipi ynë i futbollit A janë përjashtuar nga skuadra. Koordinatori i Përgjithshëm i ekipeve tona të futbollit, Samet Aybaba, njoftoi se Vincent Aboubakar, Valentin Rosier, Eric Bailly, Rachid Ghezzal dhe Jean Onana u përjashtuan nga skuadra për shkak të performancës së tyre të dobët dhe papajtueshmërisë brenda ekipit”, thuhet në njoftimin e Beshiktashit. Beshiktashi zë vendin e pestë me 26 pikë pas 15 ndeshjeve.

## Ancelotti: Një pikë ndaj Betisit nuk është keq

Trajneri i Realit të Madridit, Carlo Ancelotti, ka thënë se një pikë nga ndeshja kundër Betisit (1-1) në “Benito Villamarin” nuk është keq për Real Madridin. “Ndonjëherë

gjërat nuk shkojnë ashtu siç dëshirojmë. Ishte një ndeshje e vështirë, me gabime dhe aspekte pozitive. Gjëja e keqe që ndodhi është se Ruibal shënoi një gol

fantastik dhe ata na barazuan. Jam i kënaqur gjithsesi, sepse një pikë këtu nuk është shaka. Nuk mund të fitosh gjithmonë. Deri tani kemi bërë mirë dhe do të vazhdojmë të

bëjmë mirë. Kthehemi në Madrid me të mirat që na ofroi kjo ndeshje”, ka thënë Ancelotti. Trajneri italian foli edhe për zemërimin e Modriqit: “Nuk e di

nëse Modriqi ishte i zemëruar. Për fat të keq, morëm një gol kur e kishim ndeshjen nën kontroll, por Betisi nuk e meritonte të humbiste”.





Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2, dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 01.12.2010, lidhur me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A., në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. – Vushtri, e duke u bazuar në vendimin me nr. 1733/23 të datës 11.12.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 11.12.2023 shpall:

### KONKURS PUBLIK

#### I. Titulli: Zyrtar përgjegjës për marketing

**Numri i ekzekutuesve:** 1

**Orët e punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

**Përgatitja profesionale:** Përgatitje Universitare

**Përvoja e punës:** Preferohet një (1) vit

**I raporton:** Zyrtares Kryesore Financiare

**Koeficienti i pagës:** Sipas aktit të brendshëm të ndërmarrjes

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Asiston në aktivitete të ndryshme në ekzekutimin e planeve të marketingut;
- Asiston në implementimin e strategjisë të marketingut;
- Asiston në menaxhimin dhe organizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve;
- Menaxhon dhe realizon shpërndarjen e materialeve të Marketingut sipas planit të Marketingut;
- Përkujdeset për materialet e zyrës si: vizitkarta, memorandume, dosje dhe të tjera, të cilat kanë karakter promovues për kompaninë;
- Bashkëpunon dhe kontrollon cilësinë e punëve të kryera nga kompanitë e kontraktuara të marketingut;
- Mban kontakte të vazhdueshme me mediat, studiot, agjencitë dhe furnitorët;
- Planifikon, realizon dhe mbikëqyrë eventet dhe kampanjat e ndryshme të marketingut.
- Për punën e vet i përgjigjet Zyrtares Kryesore Financiare.

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sille të noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Dëshmitë për përvojën e punës (Nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sille të formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);.

#### Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrat e N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrisë, rr. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. **Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 11.12.2023 deri me datë 26.12.2023 në ora 16:00.**

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr.tel. 044 - 732 - 058.

**Vërejtje:** Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Na osnovu članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, članovima 11, 21, stav 2.2, i 25 Pravilnika br. 55/21 o radu "Përparimi" S. A., u Vučitrnu, usvojenog dana 21.12.2021. od strane Upravnog odbora "Përparimi" S. A - Vučitrn, i na osnovu odluke broj 1733/23 od 11.12.2023, godine od strane Izvršnog direktora, "Përparimi" Sh. A., dana 11.12.2023, objavljuje:

### JAVNI KONKURS

#### I. Naslov: Službenik odgovoran za marketing

**Broj izvršilaca:** 1

**Radno vreme:** 40 sati nedeljno

**Trajanje imenovanja:** Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

**Stručna priprema:** Univerzitetsko obrazovanje

**Radno iskustvo:** Poželjno jedna (1) godina

**Izveštava:** Glavni finansijski službenik

**Koeficijent plate:** 3.9

#### Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Pomaže u različitim aktivnostima u sprovođenju marketinških planova;
- Pomaže u implementaciji marketinške strategije;
- Pomaže u upravljanju i organizovanju aktivnosti i događaja;
- Upravlja i sprovodi distribuciju marketinškog materijala prema planu Marketinga;
- Brine o kancelarijskom materijalu kao što su: vizitke, memorandumi, fascikle i drugi, koji imaju promotivni karakter za preduzeće;
- Saraduje i kontroliše kvalitet radova koje izvršavaju angažovane marketinške kompanije;
- Održava stalne kontakte sa medijima, studijima, agencijama i dobavljačima;
- Planira, sprovodi i nadgleda različite događaje i kampanje marketinga.
- Za svoj rad odgovara Glavnom finansijskom službeniku

#### Uz prijavu je potrebno priložiti sledeće:

- Aplikacioni formular od "Përparimi" S. A - Vučitrn.;
- Dokazi o stručnoj kvalifikaciji (overene kopije diploma);
- Izvod iz matične knjige rođenih (originalni dokument);
- Dokazi o radnom iskustvu (nije obavezno);
- Kopija lične karte;
- Potvrda suda koja potvrđuje da nije pod istragom i koja se predaje u originalnom obliku (ne starije od 6 meseci);.

#### Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavnii formular u kancelariji Arhiva N.P.L. „Përparimi“ Š. A u gradu Vučitrnu, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkuriraju moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 11.12.2023. do 26.12.2023 u 16:00 časova.

N.P.L. "Përparimi" Š. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.



C.nr. 104/2015

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Civil,** si gjykatë civile e shkallës së parë me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Binak Duqi dhe sekretarja juridike Fexhrije Sejdiu, në çështjen juridiko civile të paditësve: Shaban Dibrani, i ndjerë tani 1. Sanije (Bajram) Dibrani, 2. Makfirete (Shaban) Dibrani, 3. Mimoza (Shaban) Dibrani, Naim (Shaban) Dibrani, 5. Driton (Shaban) Dibrani dhe Komuna e Podujevës, tani me adresë të panjohur në Serbi, duke vendosur sipas padisë të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, në seance publike, të mbajtur me datë 12.10.2023 merr këtë:

**AKTVENDIM**

Caktohet si përfaqësuese e përkohshëm avokate Fitore Mahmuti nga Podujeva, për të paditurin Miloje Obradović (Mitra) ish nga fshati Revuçë tani me adresë të panjohur në Serbi. Përfaqësuese përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-së, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurë i saj, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

**Arsyetim**

Të paditurit Miloje Obradović (Mitra) ish nga Revuçë, Komuna e Podujevës, tani me adresë të panjohur në Serbi, në padi thuhet se është me adresë të pa njohur diku në Serbi, prandaj paditësi ka propozuar gjykatës që të njëjtës t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm nga radha e listës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-së, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurë i saj, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Nga e gjitha kjo u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 79.3 nën b) të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË,  
Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Civil  
C.nr.104/2015 datë 12.10.2023**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykatë.

**Esmā Basholli**  
Përkthyes - Interpret gjyqësor e gjuhëve:  
shqipe, kroate, serbe, maqedone, bullgare  
Sudski prevodilac - tumač za jezike:  
albanski, hrvatski, srpski, makedonski, bugarski  
Nr. 384/2023 od 9.10.2023  
TIP-044/300.188.049/101-072  
C.nr.104/2015

**OSNOVNI SUD PRIŠTINA - OGRANAK U PODUJEVU, Opšte odeljenje, Građansko odeljenje,** kao građanski prvostepeni sud sa sudskim većem u sastavu sa sudijama Binak Dući i pravni sekretar Fedžrije Sejdiu, u parničnom; Šaban Dibrani, i. Sanije ((Bajram) Dibrani, Makfire (Šaban Dibrani, 3. Mimoza (Šaban) Dibrani), Naim (Šaban) Dibrani, 5. Driton (Šaban) Dibrani, 6, Artan (Šaban) Dibrani, protiv tuženog Miloja Obradovića ( Mitra ), ranije iz Revučë, opština Podujevo, sada sa nepoznatom adresom u Srbiji, odlučivši da prema tužbi, tužiocu za imenovanje privremenog zastupnika, na javnoj raspravi, održanoj 12.10.2013.godine je doneseno ovo:

**REŠENJE**

Za privremenog zastupnika okrivljenog Miloja Obradovića (Mitra), iz sela Revučë, sada sa nepoznatom adresom u Srbiji, postavlja se advokat Fitore Mahmuti iz Podujeva. Privremeni zastupnik u smislu člana 82. ZPP. Ima sva prava i dužnosti zakonskog zastupnika, koje vrši do pojave tuženog ili punomoćnika u sudu, koje ostvaruje dok se tuženi, odnosno punomoćnik ne pojavi pred sudom, odnosno dok organ starateljstva ne obavesti sud da je postavio staratelja.

**Obrazloženje**

Tuženi Miloje Obradović, (Mitra), ranije iz Revučë, opština Podujevo, sada sa nepoznatom adresom u Srbiji, u tužbi se navodi da ima nepoznatu adresu negde u Srbiji, pa je tužilac predložio sudu da se isti zastupnik imenuje privremeno sa liste Advokatske komore Kosova.

Privremeni zastupnik u smislu člana 82. ZPP ima sva prava i dužnosti zakonskog zastupnika, koje vrši sve dok se tuženi ili zastupnik ne pojavi pred sudom, odnosno dok sud ne upozna da je odredio Ovlašćenog.

Iz svega navedenog, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke u skladu sa članom 79.3 pod b) ZPK.

**OSNOVNI SUD PRIŠTINA – FILIJALA U PODUJEVU  
Opšte odeljenje, Građansko odeljenje  
C. br... 104/2015 od 12.10.2023**

**PRAVNI SAVET:** Protiv ove Odluke nezadovoljna stranka ima pravo žalbe u roku od 15 dana, od dana prijema ove odluke, Apelacionom sudu u Prištini, a preko ovog suda.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Petrol Company” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Deponimin e Derivatit Kerozin në Rezervuarin 3 me kapacitet 1300 m<sup>3</sup>, Z.K. Miradi e Poshtme, Komuna Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 31.01.2024 në ora 10:00 në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Vëllezrit Frashëri”, Miradi e Epërme, Komuna Fushë Kosovë do të organizohet Debat Publik nga Kompania “Petrol Company” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwurmZ253eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Petrol Company” Sh.p.k. Prishtinë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “La Reina Dresses” Sh.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 811923110 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “La Reina Dresses” D.O.O. od Vuçiterna, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 811923110 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability “La Reina Dresses” L.L.C. with headquarters in Vushtrria, has come to the decision to quit its business: 811923110 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

### K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi)

**I. Emërtimi i vendit të punës: Drejtor/e Teknik/e**

**Përgaditja profesionale:** Fakulteti Teknik, niveli MSc apo Inxh. i diplomuar – Përparësi drejtimi i Hidroteknikës.

**Përvoja e punës:** Tri (3) vite përvoja pune, prej tyre së paku dy (2) vite menaxheriale

**Numri i kryesve:** (1)

**Koeficienti i pagës:** 991.25 Euro

**Kushtet të veçanta:** - Njohja e kompjuterit (word, Exel, Auto Cad etj), Certifikimet dhe trajnime shtesë me përparësi.

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Përgjegjës kryesore për drejtimin e Drejtorisë Teknike duke filluar nga Planifikimi, Organizimi, Udhëheqja,
- Obligohet për bashkëpunim të ngushtë me: Kryeshefin Ekzekutiv, Drejtorin Komercial, Zyrтарin/en Kryesor/e Financiar/e dhe Menaxherët/et Operativ,
- Planifikon aktivitet teknike të drejtorisë duke përfshirë të gjitha sektorët e ujit të pijes dhe ujërave të ndotura, Objektet prodhuese të ujit, kualitetin e ujit, etj.
- Organizon dhe udhëheqë me të gjitha departamentet teknike për shërbime efikase dhe te përditshme të Kompanisë,
- Koordinimin e punëve dhe operacioneve për nevoja të kompanisë në nivel rajonal,
- Organizon dhe udhëheq me personelin e të gjitha departamenteve teknike në mënyrë efikase dhe njëkohësisht monitoron dhe kontrollon aktivitet e përditshme të kompanisë,
- Përkujdeset për një mirëmbajtje efikase me kosto të ulët të shpenzimeve,
- Merr pjesë në hartimin dhe implementimin e Planit të Biznesit, mirëmbajtjen, prodhimin dhe investimet kapitale si dhe bashkëpunon ngushtë me Institucionet e vendit dhe Donatorë të ndryshëm,
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv,
- Për punën që kryen i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë.

**Dokumentet e kërkuara:**

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Referencat,
- Kopja e letërnjoftimit.

**Mënyra e aplikimit:**

- Aplikacionet mund të merren ueb-faqen e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>, si dhe fizikisht në zyrën për Burime Njerëzore, dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data **12.12.2023** deri me datën **26.12.2023**
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.
- Dokumentet e pranuar të aplikantëve të fotokopjuara nuk kthehen.
- Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatët nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë.

**VËREJTJE:** Kandidatët të cilët paraqesin aplikacionin e pa-plotësuar, apo nuk i bashkëngjisin dokumentet e kërkuara si në konkurs, aplikimet e tyre do të refuzohen dhe të njëjtit nuk do të i nënshtrohen procedurës së rekrutimit.



U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212 i Administrativnog uputstva za regulisanje tenderskih postupaka u javnom sektoru br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici, je objavila ovaj:

### OGLAS ZA RADNO MESTO

(Za popunjavanje slobodnih radnih mesta šest (6) meseci probni rad sa mogućnošću produženja)

**I. Naziv radnog mesta: Tehnički direktor**

**Profesionalna kvalifikacija:** Tehnički Fakultet, Magistar ili diplomirani inženjer - Prednost na smeru Hidrotehnika.

**Radno iskustvo:** Tri (3) godine, od kojih najmanje dve (2) godine iskustva u rukovodstvu

**Broj pozicija:** (1)

**Koeficijent plate:** 991.25 €

**Posebne veštine:** Poznavanje rada na računaru (Word, Excel, Auto Cad, itd.), sertifikati i dodatne obuke.

**Opis radnih obaveza i odgovornosti:**

- Može da obavlja poslove sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Ima glavnu odgovornost za upravljanje tehničkom direkcijom, uključujući planiranje, organizaciju, upravljanje;
- Obavezuje se da blisko saraduje sa glavnim izvršnim direktorom, komercijalnim direktorom, glavnim finansijskim direktorom, operativnim menadžerima;
- Planira tehničke aktivnosti direkcije, uključujući sve sektore voda za piće i kanalizacionih voda;
- Prati objekte za proizvodnju vode i kvalitet vode
- Organizuje i upravlja svim tehničkim odeljenjima za efikasne i ažurirane usluge kompanije
- Koordinira radove i poslovanje za potrebe preduzeća na regionalnom nivou
- Organizuje i efikasno rukovodi osobljem svih tehničkih odeljenja i prati i kontroliše dnevne aktivnosti kompanije;
- Obezbeđuje efikasno održavanje uz niske troškove;
- Učestvuje u izradi i sprovođenju poslovnog plana, održavanja, proizvodnje i kapitalnih investicija i blisko saraduje sa nacionalnim institucijama i raznim donatorima;
- Izveštava svoj rad kod glavnog izvršnog direktora kompanije.

**Potrebna dokumentacija:**

Zainteresovani kandidati moraju popuniti prijavu Preduzeća i uz prijavu priložiti sledeću dokumentaciju:

- CV (Biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitetska diploma (overena kopija, dok diploma sa univerziteta u inostranstvu mora biti nostrifikovana),
- Dokaz nadležnog suda da nije pod istragom, ne stariji od 6 meseci,
- Dokaz o stručnom usavršavanju,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Reference,
- Kopija lične karte.

**Način prijave:**

- Prijave se mogu dobiti na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>, kao i fizički u Službi za ljudske resurse, i dostaviti istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom u štampanom obliku.
- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja od **12.12.2023 do 26.12.2023**.
- Prijave dostavljene nakon isteka roka se ne prihvataju.
- Prihvaćena dokumenta podnosiocima prijava u fotokopijama se ne vraćaju.
- Regionalno Vodovodno Preduzeće "Mitrovica" d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidate iz manjinskih grupa, kao i osobe sa invaliditetom da se prijave.

**NAPOMENA:** Kandidatima koji podnesu nepotpunu prijavu, ili ne prilože traženu dokumentaciju kao u oglasu za konkurs, prijave će biti odbijene i neće biti predmet postupka prijema.



